

Me
Dana

07-05-2018

P.nr. 3182/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
Divizioni penal si gjykate e shkallës së parë me gjyqtaren , Hysnije Gashi si dhe me
zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër te akuzuarit, [REDACTED] me
vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Malisheve, për shkak te veprës penale rrezikimi
i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së
Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 2149-7/16 të dt.18.12.2017, duke vendosur
lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë,
gjykata me dt.13.02.2018 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr. 2149-7/16 të dt.18.12.2017, dhe kjo
gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri

[REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Malisheve, i lindur
me [REDACTED], nga i ati [REDACTED], ka te mbaruar shkollën e mesme, i gjendjes se mesme
ekonomike, i martuar me numer personal te letnjoftimit [REDACTED] shqiptar, shtetas i
Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.11.2016, rreth orës 14:40, duke lëvizur ne rrugen Shtime – Prizren dhe
me të arritur ne fshatin Belincë, Komuna Shtime duke drejtuar automjetin e markes “VW
Caddy” me targa te regjistrimit [REDACTED], ashtu që duke vepruar në kundërshtim me
nenin 120/1 te LSKRR-së, nga pakujdesia dhe duke mos mbajtur distancën e siguris mes
automjetve me pjesen e përparme e godet ne pjesen e pasme automjetin e markes “Opel
Combo” me targë te regjistrimit [REDACTED] hte cilin [REDACTED], me te cilin rast pos

dëmve materiale lëndime te lehta trupore pësojne [REDACTED], lëndime keto te pershkruara ne ekspertizen mjeko ligjore te dates 14.12.2017, -

Me te cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KPRK-së.

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurit, me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDACTED], nga komuna Drenas per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civil .

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 2149-7/16 të dt.18.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] me vendbanim ne fshatin [REDACTED], Komuna Malisheve, për veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.

2149-7/16 të dt.18.12.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit e datës 29.11.2017, ekspertiza mjeko-ligjore të datës 14.12.2017, deklarata e te pandehurit e dates 03.11.2017 deklarata e te demtuarit të demtuarit të dates 03.11.2016 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lendes vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga komuna Drenas për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil .

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DIVIZIONI PENAL


P.nr.3182/17 dt.13.02.2018

Zyrtare ligjore,

Albana Ujupi

Gjyqtari i vetem gjykues,

Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.